

**PROTOKOLL PËR ZBATIMIN**  
**E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT KËRKIMOR-SHKENCOR DHE**  
**ARTISTIK MIDIS AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË DHE**  
**AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS**

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (në vazhdim ASHSH) dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (në vazhdim ASHAK), në zbatim të Marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor-shkencor dhe artistik të nënshkruar ndërmjet tyre më 08.09.2000 në Tiranë, ranë dakord të zhvillojnë këto veprimitari të përbashkëta:

- 1. Shënimi i 100-vjetorit të vdekjes se Jeronim De Radës.** Projekt i përbashkët i ASHSH (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë) dhe ASHAK (Sekcioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë dhe Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare), 2003;
- 2. Rrjedhat e letërsisë bashkëkohore shqiptare** (tubim shkencor). ASHAK (Sekcioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë), në bashkëpunim me ASHSH (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë), 2003-2004;
- 3. Klasifikimi i llojeve të prozës dhe të poeziës popullore.** Projekt i përbashkët i Institutit Albanologjik të Prishtinës dhe Institutit të Kulturës Popullore të ASHSH (Simpozium shkencor dhe botimi i materialeve), 2003-2004;
- 4. Çështje të standardizimit të shqipes dhe të terminologjisë.** Bashkëpunim i vazhdueshëm midis ASHSH (IGJL) dhe ASHAK (SGJL) për harmonizimin e qëndrimeve në këtë fushë;
  - Tryezë e rrumbullakët: “**Gjendja e përdorimit publik të gjuhës shqipe**” (ASHSH-IGJL dhe ASHAK-SGJL), 2003 e në vazhdim;
- 5. Leksikografia shqiptare – arritje dhe probleme.** Konferencë shkencore dhe botimi i materialeve. Projekt i përbashkët i ASHSH (IGJL) dhe ASHAK (SGJL), 2004;
- 6. Enciklopedia Shqiptare.** Projekt i përbashkët i dy Akademive, 2003 e në vazhdim;
- 7. Enciklopedia e artit shqiptar.** Projekt i përbashkët i ASHSH (QSA) dhe ASHAK (SA), 2003 e në vazhdim;
- 8. Fjalor me fjalë dhe me shprehje popullore.** Hartimi dhe botimi i fjalorit. Projekt i përbashkët i ASHSH (IGJL) dhe Institutit Albanologjik të Prishtinës, 2004;
- 9. Fjalor i termave të informatikës.** Hartimi dhe botimi i fjalorit. Projekt i përbashkët i ASHAK (SGJL) dhe ASHSH (IGJL dhe INIMA), 2004;
- 10. Fjalor i termave të muzikës.** Hartimi dhe botimi i fjalorit. Projekt afatmesëm i përbashkët i ASHSH (IGJL dhe QSA) dhe ASHAK (SA), 2003 e në vazhdim;
- 11. Fjalor i botanikës.** Hartimi dhe botimi i fjalorit. Projekt i përbashkët ASHAK (Sekcioni i Shkencave të Natyrës) dhe ASHSH (IGJL, IKB dhe FSHN), 2005;

**12. Fjalor terminologjik hidrometeorologjik e mjedisor.** Hartimi dhe botimi i fjalorit. Projekt i përbashkët i ASHSH (IGJL dhe IH) dhe ASHAK (SSH), 2003 e në vazhdim;

**13. Fjalor i termave të folklorit dhe etnologjisë.** Hartimi dhe botimi i fjalorit. Projekt i përbashkët i Institutit Albanologjik të Prishtinës dhe Institutit të Kulturës Popullore të ASHSH, 2003 e në vazhdim;

**14. Veshjet popullore të Kosovës.** Projekt studimor dhe botim i Albumit përkatës i Institutit Albanologjik të Prishtinës dhe Institutit të Kulturës Popullore të ASHSH, 2003 e në vazhdim;

**15. Hasi – studim folkloriko-etnologjik.** Projekt i Institutit Albanologjik të Prishtinës, në bashkëpunim me Institutin e Kulturës Popullore të ASHSH, 2003 e në vazhdim;

**16. Kërkime arkeologjike në Kosovë.** Përpilimi i Hartës arkeologjike të Kosovës, gërmime arkeologjike sipas projekteve të Muzeut të Kosovës dhe botime të përbashkëta sipas interesave të dyanshme. Projekt i përbashkët i Muzeut të Kosovës dhe Institutit Arkeologjik të Tiranës (financimi i përbashkët i këtyre institucioneve), 2003 e në vazhdim;

**17. Arkitektura popullore – tradicionale shqiptare** (aspekti etnografik). Projekt i përbashkët i ASHAK (Seksioni i Shkencave Shoqërore) dhe ASHSH, 2003 e në vazhdim;

**18. Shqipëria dhe Kosova pas Luftës së Ftohtë.** Botim i materialeve studimore. Projekt i përbashkët i Institutit të Historisë të ASHSH dhe Institutit të Historisë të Prishtinës, 2004;

**19. Lidhja Shqiptare e Prizrenit.** Konferencë e përbashkët shkencore me rastin e 125 vjetorit të Lidhjes. Në Prizren: IHP dhe ASHAK dhe IHT të ASHSH, 2003;

**20. Pasuritë ujore dhe klimatike të Shqipërisë dhe të Kosovës.** Botim i materialeve studimore. Projekt afatmesëm i Institutit Hidrometeorologjik të ASHSH dhe ASHAK, 2003 e në vazhdim;

**21. Vlerësimi i burimeve natyrore të Bjeshkëve të Nemuna (Alpet Shqiptare) dhe mbrojtja e tyre.** Konferencë shkencore. Projekt i përbashkët i ASHSH dhe ASHAK dhe i institucioneve përkatëse shkencore të Shqipërisë dhe të Kosovës, 2004;

**22. Sistemi i vrojtimit hidrometeorologjik dhe mjedisor në pellgun e ujëmbledhësit të Drinit të Bardhë** (ngritura e sistemit të vrojtimit), IHMT dhe IHMK, 2003 e në vazhdim;

**23. Rrjeti për shkëmbimin e informacionit hidrometeorologjik** (ngritura e rrjetit për shkëmbime informacioni operativ), IHMT dhe IHMK, 2003 e në vazhdim;

**24. Sistemi për parashikimin afatshkurtër të motit** (krijimi i sistemit për parashikimin afatshkurtër të motit), IHMT dhe IHMK, 2003 e në vazhdim;

**25. Ekspozitë e Përherershme Etnografike.** Projekt i Muzeut të Kosovës, në bashkëpunim me Institutin e Kulturës Popullore të ASHSH;

**26. Ekspozitë e përbashkët të anëtarëve të ASHAK.** Projekt i përbashkët i ASHAK, në bashkëpunim me ASHSH dhe Galerinë Kombëtare të Arteve të Tiranës, Tiranë 2003;

**27. Ekspozitë e anëtarit korrespondent Tahir Emra.** Projekt i ASHAK, në bashkëpunim me ASHSH dhe Galerinë Kombëtare të Arteve të Tiranës, Tiranë 2004;

**28. Inskenimi i operës së Akademik Rauf Dhomit “Dasma arbrëreshe”.** Projekt i përbashkët ASHAK dhe Ministrisë së Kulturës të Kosovës, në bashkëpunim me Teatrin e Operës dhe të Baletit të Tiranës, në Prishtinë dhe në Tiranë 2003;

**29. Koncert me veprat simfonike të anëtarëve të jashtëm të ASHAK** (Çesk Zadeja dhe Tish Daija). Projekt i përbashkët i ASHAK dhe Filharmonisë së Kosovës dhe Teatrit të Operës dhe të Baletit, në Prishtinë dhe në Tiranë 2003;

**30. Bashkëpunim në fushën e elektroenergjetikës sipas interesave të përbashkëta shkencore të dy Koorporatave elektroenergjetike** (projektet mund të konkretizohen më vonë - shih shtojcën).

Për secilën prej veprimtarive të mësipërme do të hartohen programe të posaçme pune të miratuara nga organet përkatëse të institucioneve bashkëpunuese.

Për të ndjekur ecurinë e realizimit të veprimtarive të parashikuara në këtë Protokoll, përfaqësues të dy palëve do të takohen të paktën një herë në vit. Vendi dhe data e takimit do të caktohen me korrespondencë.

Ky Protokoll mund të ndryshohet ose të shtohet me miratimin e të dy palëve.

Protokolli është i vlefshëm për një periudhë dyvjeçare që nga data e nënshkrimit.

Nënshkruar në Prishtinë, më 21 shkurt 2003, në dy kopje, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë.


**PËR AKADEMINË E SHKENCAVE  
DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS**

**NËNKRYSHTARI**

  
**Akademik Besim Bokshi**

**PËR AKADEMINË E SHKENCAVE  
TË SHQIPËRISË**

**ZËVENDËSKRYSTARI**

  
**Akademik Luan Omari**